



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

**KONTRATA PUBLIKE KORNIZË PËR SHËRBIME
(ME NJE OPERATOR EKONOMIK)**

KOMUNA E ISTOGUT, Njesija e Prokurimit të cilën e përfaqëson Menaxheri-ja e Prokurimit z-nja Zizë Bujupaj, Adresa Rruga "Fadil Ferati" nr 121. Me nr tel 038 200 43 858, në cilësinë e porositësit të shërbimeve të Autoritetit Kontraktues në njëren anë;

dhe

KONZORCIUMI "SIB BKA" SHPK & N.SH. "LIRIU" me seli në Suharekë, Komuna e Suharekës i përfaqësuar nga i autorizuari Sami Kolgeci, në cilësinë e LIDERIT të konzorciumit të Nr. Rexhistrimit të biznesit: 70926393 përkatësisht 70904101 në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve", në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për Shërbimet në vijim:

MBIKQYRJA E PROJEKTEVE KAPITALE PER VITIN 2018

Nr. I prokurimit	633-18-1469 2-2-1/ FA 25
Nr. I brendshëm	633 / 018 / 011 / 221

Neni 1 Lënda e kontratës: MBIKQYRJA E PROJEKTEVE KAPITALE

Objektit të kësajë kontratë do të jetë MBIKQYRJA-PERCJELLJA E PROJEKTEVE KAPITALE TË CILAT DO TË REALIZOHËN NE VITIN 2018 NË KOMUNËN E ISTOGUT SIPAS OFERTËS SE OFRUESIT TË SHËRBIMEVE 633-18-011-221 datë 03.04.2017.

1.1 Kontrata kornizë publike do të implementohet me "thirrje" atëherë kur Autoriteti Kontraktues vendos ta angazhojë ofruesin e shërbimeve për mbikqyrjen e Projektit në fjalë.

Obligimet e kryersit te sherbimeve:

- > Të sigurojë se është bere piketimi I objektit (objekteve) qofshin ato: Rrugë, Kanalizim, Ujësjetles, ndertim etj, nga personi I autorizuar bazuar ne projektin për ndertim.
- > Ti pëcjellë punimet konform projektit, bazuar në paramasën dhe parallogarinë e ofertes financijare.
- > Të mbikqyrë punimet, materialet, dhenë pajtim me kërkesat e projektit dhe dokumentacionit tjeter percjelles.
- > Të sigurojë takime me personat e autorizuar sa here qe kjo është e nevojshme dhe e dobishme per marevajtjen e punimeve.
- > Të Njoftojë AK-në per te gjitha ndryshimet, plotesimet eventuale per gjat ekzekutimit te projektit ne realizim.
- > Po qe se veren ndonje leshim, te informojë per mangesite ose parregullsitë eventuale g jate ekzekutimit.
- > Të perpiloje një plan detal te fillimit dhe perfundimit te puneve, plani I menaxhimit
- > Të perpilojë raportin per fazën e punimeve,
- > Të mirembaje ditarin dhe librin ndertimor me nenshkrimin e personit te autorizuar.
- > Të mos I lejohet ndryshimi apo punë shtesë pa pelqimin e (menaxherit te projektit).
- > Të njoftoje AK-në për secilën fazë te punimeve dhe poashtu hartimin e situacioneve, vertetimin dhe miratimin per pagese te tyre.

Si dhe te gjitha obligimet te parashtruara në dhe të percaktuara ne specifikimin e detyrueshëm teknik te dosjës së tenderit, e cila është pjese përbërese e kontratës, e qe do t'i bashkangjitet te njëjtës.

1.2 Autoriteti Kontraktues sipas kësajë kontrate kornizë do të te kryeje sherbimet ne emër te vet.

Neni 2. Çmimi

2.1 Çmimi i kësajë kontrate per sherbimet e kryera është per njësi matese prej: 0.585 % nga vlera e projekteve kapitale te realizuara. Vlera e PERAFERT e projekteve është: 2.200.000 x 0,585 % = 2,200,000.00 €

Oferta Financiare e Ofruesit të Shërbimeve të datës 06. 04. 2018 do të jetë pjesë përbërese e kesajë kontrate.

2.2 Ky çmim mund të ndryshojë sipas: (Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, neni 38 paragrafi 2, lejon $\pm 30\%$ e vlerës së kontratës) po që se për këtë paraqitet nevoja nga Autoriteti Kontraktues.

Po që se urdherblerjet kalojnë sasinë totale të kontratës publike kornizë (duke përfshirë $+ 30\%$), pa marrë parasysh datën origjinale të nënshkrimit, e njëjta shkeputet automatikisht.

2.3 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës, bazuar në situacionet dhe raportet e organit mbikqyrës të nënshkruara dhe vëltura nga ana e tij dhe dokumentacionit përcjellës për pagesë.

Neni 3. Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës:

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Kontrata Publike

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;

Oferata financiare (Lista e Çmimeve);

Urdhër blerja;

Plani për menaxhimin e kontratës

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cëkin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimin të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimin të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të

shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.




4.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët Angleze Shqipe [Serbe]¹ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Ofruesin e Shërbimeve.

Neni 5 Afati i kontrates kornizë:

Kjo kontratë kornizë do të jetë efektive për periudhën prej: 9 muajsh, perkatesisht deri me 31.12.2018. dhe e njejta do të hyjë në fuqi me datën e nënshkrimit nga të dyja palët kontraktuese.

Neni 6 Menaxheri i kontratës:

Menaxher i KONTRATËS do të caktohet Drejtori i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim

Për Autoritetin Kontraktues:		Për ofruesin e shërbimeve:	
Emri:	Zize Bujupaj	Emri:	Sami KOLGECI
Pozita:	Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit	Pozita:	Lider i grupit të konzorciumit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	08.06.2018	Data:	08.06.2018
Vula:		Vula:	

Specifikimi teknik dhe paramasa

Në realizimin e objektivave për zbatimin e punimeve të projekteve Mbikëqyrësi menjëherë mbas lidhjes së kontratës duhet :

1. Të mbikëqyrë Kontratën e zbatimit të punimeve në emër të Komunës së Istogut dhe të kryejë të gjitha detyrimet e besuara atij sipas Kontratës së nënshkruar, dhe Ligjeve aktuale
2. Të njihet në detaj me projekt zbatimin dhe specifikimet teknike të objektit , të hartoj programin e kontrollit për zbatimin e projektit dhe cilësisë së punimeve në bazë të standardeve dhe ligjeve në fuqi.
3. Të paraqesë pranë Komunës së Istogut stafin e tij mbikëqyrës.
4. Drejtuesin e punimeve, që duhet të jetë inxhinier ndërtimi ose arkitekt me eksperience pune në mbikëqyrje i cili mban përgjegjësi për zbatimin e projektit sipas kushteve teknike të zbatimit, miratimin e volumeve të punimeve, certifikatën e pagesës, mbajtjen, kontrollin dhe miratimin e gjithë dokumentacionit, miratimin e ndryshimeve të volumeve, korrespondencën me Komunën e Istogut, cilësinë e punimeve etj.
5. Mbikëqyrësin për punime arkitektonike që duhet të jetë arkitekt me eksperiencë pune në këtë fushë i cili miraton materialet dhe cilësinë e tyre dhe ndjek e miraton cilësinë e punimeve.
6. Mbikëqyrësin për punimet elektrike që duhet të jetë inxhinier elektrik me eksperiencë pune dhe stafin tjetër për punime (inxhinieret përkatës të drejtimeve të kërkuara sipas kriterëve në dosje të tenderit).
7. Të kontrolloj certifikatat e cilësisë së materialeve dhe të jap miratimin për vendosjen në objekt të tyre , gjatë zbatimit të projektit, i jep instruksione me shkrim OE, sa herë që e sheh të nevojshme, dhe OP është i detyruar t'i zbatojë ato. Për çdo rast, që gjatë zbatimit të punimeve lind nevoja e ndryshimeve në Projekte dhe paramasete parashikuar, Mbikëqyrësi i Punimeve duhet t'i paraqesë relacion të plotë teknik (shoqëruar me skicat përkatëse) ku argumentohet ndryshimi. **Ndryshimi në objekt (zbatimi i punimeve) do të bëhet vetëm pas miratimit nga Komuna e Istogut, të nënshkruaj aktin përfundimtar të kontrollit të punimeve për faza të ndryshme .**
8. Në çdo fund muaji mbikëqyrësi ka për detyrë të paraqes pranë AK raport mujor të punimeve. Në këtë raport duhet të tregohet për avancimet të punimeve dhe të pagesave të kryera. Raporti Mujor do të ketë këtë përshkrim të Punimeve që janë kryer gjatë muajit, fotografi të proceseve të punëve të kryera , situacionet mujore. Raporti Mujor do t'i dorëzohet Drejtorive përkatëse dhe do t'i përgjigjet të gjitha kërkesave të saj.
9. Ruajtjen e të gjithë dokumentacionit dhe korrespondencën, urdhëratë e ndryshme që ai ka dhënë gjatë zbatimit të kontratës, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që e kanë diktuar këto ndërprerje.
10. Mbikëqyrësi ka të drejtë : Të kërkojë largimin nga puna të drejtuesit të kantierit ose të punëtorëve të veçantë për mosbindje, paaftësi ose pakujdesi të rëndë. Të pezullojë punimet kur sheh se në objekt nuk janë marrë masat e duhura për të siguruar punimet dhe trafikun.
11. Të mos lejoj vendosjen në vepër të materialeve që nuk plotësojnë kushtet e cilësisë dhe ti zëvendësoj ato me materiale të tjera nga OE me shpenzimet e tij, të kërkojë certifikatat e cilësisë , të kërkojë dhe të asistojë në kryerjen e provave të materialeve, për të verifikuar cilësinë e tyre. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të OE, në rast se materialet e përdorura nuk miratohen nga mbikëqyrësi këto duhet të dokumentohen me procesverbalet e analizave.

12. Të kërkojë kryerjen e provave shtesë për materialet e vendosura në objekt, kur këto nuk janë kryer në masën sipas vëllimeve të realizuara dhe pjesë së lëndës së parë të furnizuar për të verifikuar cilësinë. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të OE.
13. Kur Mbikëqyrësi i Punimeve mendon se ka dëmtime në konstruksion, kërkon të bëhen verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë mbikëqyrësit, shpenzimet janë në ngarkim të OE.
14. Mbikëqyrësi i Punimeve urdhëron OE të prishë dhe të ribëjë me shpenzimet e tij, punime të bëra jo me cilësinë e parashikuar në Projekt dhe Specifikimet Teknike.
15. Mbikëqyrësi i Punimeve ka të drejtë të pezullojë përkohësisht punimet, për ekzekutim teknik të gabuar ose paaftësi teknike zbatimi, për çdo rast me miratimin e AK, për atë kohë sa ai e konsideron të arsyeshme.
16. Te këtë takime të rregullta me Drejtoret e njësive kërkuese në lidhje me progresin e punimeve, pengesat eventuale gjatë punës si dhe mbarëvajtjen e realizimit të projektit përkatës.
17. Ruajtjen e të gjithë dokumentacionit dhe një kopje të kompletuar të dorëzon të AK.

Gjatë këtij viti do të mbikëqyren:

1. Kanalizime.
2. Ujësjiellës
3. Rrugë
4. Kanale të vaditjes
5. Rregullime të lumenjve
6. Terrene sportive
7. Nxemje qendrore
8. Ndërtime të ambulantëve
9. Renovimi i shkollave
10. Ndriçime publike, Mirëmbajtje dhe renovim
11. Ndërtimi rrethojave të shkollave
12. Ndërtimi i trotuareve dhe renovimi apo mirëmbajtja e tyre
13. Renovime (mirëmbajtja) të rrugëve të asfaltuara, sanimi i gropave
14. Ndërtimi i urave dhe tombinave
15. Dhe projekte tjera kapitale të natyrave të ngjashme të cilat nuk janë përfshirë në këtë Listë

- Shuma e këtyre projekteve për vitin 2018 do të sillet rreth 2,200.000.00 €
- Inxhinierët (stafi profesional) që duhet të angazhohen në këtë projekt :

1. Një inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv, min 3 vjet përvojë pune (sistemin 5 vjeçar ose master).
2. Një inxhinier i diplomuar i Arkitekturës min 3 vjet përvojë pune (sistemin 5 vjeçar ose master).
3. Një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë – hidroteknik min 3 vjet përvojë pune (sistemin 5 vjeçar ose master)
4. Një inxhinier i diplomuar i elektroteknikës min 1 vjet përvojë pune (sistemin 5 vjeçar ose master).
5. Një inxhinier i diplomuar i makinerisë min 1 vjet përvojë pune (sistemin 5 vjeçar ose master).
6. Një Gjeometërmin. 1 vit përvojë pune

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.


Qëllimet për plotësimin e KVK janë dhënë sipas nevojës në shënimet/kursive të përmendhura për nenet përkatëse të KPK. Të tjerat do të jenë të rrethueshme.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë: GJUHA SHQIPE
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të Shërbimeve është PAS NËNSHKRIMIT TË KONTRAËS SIPAS KERKESËS SE NJESISË KËRKUESE, VARESISHT NGA MBIKQYRJA E PROJEKTIT PERKATES.
	6.4	Data e Përfundimit është 9 muaj pas nënshkrimit të kontratës, PERKATËSISHT deri me datë 31.12. 2018
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është KOMUNA E ISTOGUT
Obligimet Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i KONTRATËS është Drejtor i DREJTORATIT për Ekonomi dhe zhvillim e i cili do të caktohet me vendim të posaqëm..
Dëmet likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25 % për çdo ditë vonese Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës në afat prej 9 muajsh
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10 % E SHUMES SE VLERES SE PARASHIKUAR TË EKONTRATËS NE AFATIN PREJ 9 MUAJSH , nga data e nënshkrimit të kontratës.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: Për të gjitha dëmet eventuale të cilat mund të shkaktohen palëve të treta, për gjat kohës së vlershmerisë së kontratës, përgjegjësinë do ta bartë kryesi i shërbimeve.

Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Orari i pagesës do të jetë: bazuar ne raporte e MENAXHERIT pas dorëzimit te tere dokumentacionit tjetër percjellës per pagesë.
Kontrolli i kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: INSPEKTIMI I KOHË PAS KOHSHEM NGA AUTORITETI KONTRAKTUËS
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	AUTORITETI KONTRKTUES – DREJTORATI PERKATËS I IMPLEMENTMIT TE PROJEKTIT
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet GJYKATA THEMELORE-DEPARTAMNETI PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE - PRISHTINË ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh nese palët kontraktuese dakordohen pe nje gjë te tillë.

Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

KOMUNA E ISTOGUT					
MBIKQYRJA E PROJEKTEVE KAPITALE					
PARAMASA DHE PARALLOGARIA					
	Specifikimi i punëve	Njësia	Sasia e peraferte	% per njesi	Totali
1.1	MBIKQYRJA E PROJEKTEVE KAPITALE	EURO	2,200,000.00	0.585%	12,870.00 €
TOTALI ÇMIMIT ME TVSH					12,870.00 €

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI TË OET	Sib Bka shpk & NSH Liriu
EMRI DHE MBEMRI I PËRFAQESUESIT TË OET	SAMI KOLGECI
NENSHKRIMI	
DATA	06/04/2018
VULA	

